



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI ADMINISTRIMIT

Nr. 2003 / Prot.
14

Vlorë më, 19.12. 2022

VENDIM
Nr. 46, datë 19.12.2022

E. Zbomaj

**PËR
PAGESËN E PERSONELIT NDIHMËSAKADEMIK ME KARAKTER
ADMINISTRATIV PËR PUNËN E KRYER JASHTË ORARIT ZYRTAR DHE
DITËVE TË PUSHIMIT, GJATË PROCESIT TË REGJISTRIMIT PËR VITIN
AKADEMIK 2022-2023**

Në mbështetje të nenit 49, të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 25, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, VKM nr. 568, datë 06.10.2021 "Për miratimin e rregullave për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit, orët shtesë dhe kompesimin e tyre në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore", si dhe referuar propozimit të Rektorit nr. 1813/4 prot, datë 12.12.2022, shkresës nr. 1813/6, datë 14.12.2022 të Administratorit, Bordi Administrimit në mbledhjen e datës 19.12.2022,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin e ardhur me shkresën nr. 1813/4, datë 12.12.2022 për pagesën e personelit ndihmësakademik me karakter administrativ (sekretaritë mësimore), për punën e kryer jashtë orarit zyrtar dhe ditëve të pushimit, gjatë procesit të regjistrimit për vitin akademik 2022-2023.
2. Efektet financiare të këtij vendimi janë 1,908,396 lekë dhe do të mbulohen nga fondi i pagave të vitit 2022.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtorja e Shërbimeve Mbështetëse të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Sotir NIKOLLA

